




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 04.10.2017

Vendim
Nr. 87, datë 04.10.2017

PËR POZICIONIN E PUNËS "SEKRETAR I DEKANIT"/"SPECIALIST PRANË DEKANIT"

Në mbështetje të nenit 66 "Personeli ndihmësakademik" dhe nenit 38 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në funksion të zbatimit të strukturës organizative të UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.09.2017

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pozicionit të punës të përcaktuar në shkronjën *b*, pika 2 në Vendimin nr. 39, datë 06.10.2016 të Senatit Akademik "Për përcaktimin e kategorive të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor dhe personelit ndihmësakademik me karakter administrativ" nga **specialist pranë dekanit në sekretar i dekanit**.
2. Lënien në fuqi të pozicionit të punës "**sekretar i dekanit**" sipas shkronjës *f*, pika 1 në Vendimin nr. 32, datë 06.09.2016 të Senatit Akademik.
3. Ky vendim t'i bashkëlidhet vendimit të senatit nr. Nr 10, datë 27. 01. 2017.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekanët, Administratori, Drejtorja e Financave dhe Realizimit të Buxhetit si dhe Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit Zyrtar.
5. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.